

AKT I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

“INNOVA” SHPK

Në bazë të Legjislacionit Shqipëtar në fuqi, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregëtare” i ndryshuar si dhe Ligjit Nr. 9723 dt 03.05.2007 “Për Rregjistrimin e Biznesit” i ndryshuar, unë :

Isijda Sinjari, e bija e Edisonit, lindur më 10.01.1981 në Tiranë dhe banuese në Tiranë me adresë Rr. Kodra e Diellit, nd 22. Nr 302, identifikuar me kartë identiteti Nr. 031745219 dhe numër personal I15110056R, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

shpall si më poshtë vijon:

Neni 1

Sot më 11.02.2020 themelohet shoqëria e quajtur “Innova” SHPK me ortak të vetëm:

Isijda Sinjari, e bija e Edisonit, lindur më 10.01.1981 në Tiranë dhe banuese në Tiranë me adresë Rr. Kodra e Diellit, nd 22. Nr 302, identifikuar me kartë identiteti Nr. 031745219 dhe numër personal I15110056R, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 2

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Rezidenca Kodra e diellit. Rruga e jasemineve. Nd 22. Nr 170, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria mund të themelojë degë dhe filiale në të gjithë territorin e vendit si dhe jashtë tij me miratimin e organeve kompetente dhe në përputhje me legjislacionin e vendit ku do të hapen këto agjensi.

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

- a) Asistencë në marrëdhëniet me institucionet financiare, këshillime dhe bashkëpunime me dhe për sektorin publik;
- b) Ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kulturës dhe trashëgimise kulturore.
- c) Të zhvillojë studime në fushën ekonomike, financiare, juridike, sociale, eficienten e energjisë, turizmin dhe ambientin.
- d) Të organizojë evente si seminare, konferenca, fushata marketingu.
- e) Të organizojë evente kulturore si festivale, panaire, ekspozita etj.
- f) Të japë konsulencë në hartimin e strategjive, udhërrëfyesve, hartëzimit të aktorëve, punë kërkimore për organet e qeverisjes qendore dhe lokale.
- g) Të organizojë anketime dhe përpunim të dhënash statistikore.
- h) Të kryejë shërbime monitorimi dhe vlerësimi për projekte.
- i) Të ofrojë këshillime në fushën e bujqësisë, trajnime dhe ngritje kapacitetesh për fermerë apo grupe të tjerë interesi.
- j) Të zhvillojë trajnime apo ngritje kapacitetesh në fushën e edukimit financiar për publikun apo grupet e marginalizuara.

- k) Të zhvillojë trajnime dhe seminare për autoritetet e qeverisjes lokale dhe të qeverisjes qendrore;
- l) Të bëjë studime dhe të zhvillojë trajnime në fushën e administratës publike, në lidhje me menaxhimin e shpenzimeve publike, menaxhimin e borxhit publik, sistemin e administrimit të të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e Qeverisë;
- m) Të bëjë vlerësime dhe studime fizibiliteti projektesh të cilat aplikojnë për financime në organizma ndërkombëtare financiare;
- n) Të zhvillojë projekte në fushën e edukimit alternativ, ngritjen e subjekteve të reja të bazuara në programet e njohura ndërkombëtarisht si shkolla alternative;
- o) Të promovojë dhe të organizojë seminare, trajnime, përkthime, publikime dhe aktivitete të tjera ndërgjegjësuese, promovuese dhe informuese mbi çështje të zhvillimit ekonomik;
- p) Të ofrojë këshillime përfaqësimi, për marrëdhëniet me publikun, e-commerce, këshillime turistike dhe çdo lloj shërbimi apo fushatë në dobi të zhvillimit;
- q) Të zhvillojë aktivitete didaktike dhe formuese, rikualifikim dhe formim personal, përgatitje të programeve të formimit dhe menaxhimi i specialistëve apo nëpërmjet suporteve tradicionale;
- r) Përgatitje planesh biznesi për aplikime për donacione dhe grante nga organizata kombëtare dhe ndërkombëtare.
- s) Të menaxhojë projekte, për llogari të palëve të treta, projekte të cilat financohen nga donatorët e ndryshëm, të koordinojë aktivitetet e projekteve, të kryejë raportimin dhe menaxhimin financiar sipas procedurave të miratuara nga donatorët, të zhvillojë aktivitetet që lidhen me komunikimin dhe vizibilitetin e projekteve. Të prodhojë raporte dhe organizojë evente që shpërndajnë rezultatet e arritura gjatë zbatimit të projekteve, nga pale të treta.
- t) Analizë dhe vlerësim të biznesit, i strukturave operative financiare për industri të ndryshme financimeve të ndryshme, modelim i biznesit, këshillime mbi ristrukturimin e organizimit financiar, studime tregu, studime plan biznesi, transaksionet dhe strategjine e shitjeve, këshillime mbi partnershipte të ndryshme, negociime të termave të marrëveshjes, vlerësime risku dhe këshillime për mitigimin e tyre.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga një kuotë, prej 100 000 ALL dhe është kontribut i ortakut të vetëm:

Isijda Sinjari, e bija e Edisonit, lindur më 10.01.1981 në Tiranë dhe banuese në Tiranë me adresë Rr. Kodra e Diellit, nr 22. Nr 302, identifikuar me kartë identiteti Nr. 031745219 dhe numër personal I15110056R, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Ortaku i shoqërisë mund të vendosë për rritjen e kapitalit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

Detyrimet e ortakut kundrejt shoqërisë përballohen vetëm për pjesën e kapitalit të derdhur nga ai. Për detyrimet e tjera të shoqërisë ortakut nuk mban përgjegjësi.

Neni 6

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga organet e saj të cilat janë:

1. Asambleja e përgjithshme
2. Administratori

Shoqëria ka si ortak:

Isijda Sinjari, e bija e Edisonit, lindur më 10.01.1981 në Tiranë dhe bannuese në Tiranë me adresë Rr. Kodra e Diellit, nd 22, Nr 302, identifikuar me kartë identiteti Nr. 031745219 dhe numër personal I15110056R, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Dhe administrator:

Isijda Sinjari, e bija e Edisonit, lindur më 10.01.1981 në Tiranë dhe bannuese në Tiranë me adresë Rr. Kodra e Diellit, nd 22, Nr 302, identifikuar me kartë identiteti Nr. 031745219 dhe numër personal I15110056R, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Mënyra dhe drejtimi i shoqërisë janë të përcaktuara në Statutin e shoqërisë.

Neni 7

Ortaku i shoqërisë është i detyruar të ruajë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë përhapjen e tyre qoftë dhe pjesërisht.

Likuidimi

Neni 8

Nëse shoqëria do të likuidohet atëherë do të caktohet një komision likuidimi që do të parashtrojë një bilanc likuidimi për miratim.

Neni 9

Cdo mosmarrëveshje që do të lindë në lidhje me këtë marrëveshje apo Shoqërinë (përveç atyre personale apo që nuk kanë të bëjnë me Shoqërinë), do të zgjidhet me mirëkuptim dhe do të diskutohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

Në rast se nuk arrihet një zgjidhje me mirëkuptim të mosmarrëveshjes, çështja do t'i kalojë për gjykim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ortaku i SHOQËRISË "Innova" SHPK

Isijda SINJARI

Isijda Sinjari